

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 705 (I RISHIKUAR)

MODIFIKIMET E OPINIONIT NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Llojet e Opinioneve të Modifikuara	2
Hyrja në fuqi	3
Objektivi	4
Përkufizimet	5
Kërkesat	
Rrethanat kur Kërkohet një Modifikim në Opinionin e Audituesit	6
Përcaktimi i Llojit të Modifikimit në Opinionin e Audituesit	7-15
Forma dhe Përmbajtja e Raportit të Audituesit kur Opinioni është Modifikuar	16-26
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	30
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Llojet e Opinioneve të Modifikuara	A1
Rrethanat kur Kërkohet një Modifikim në Opinionin e Audituesit	A2-A12
Përcaktimi i Llojit të Modifikimit në Opinionin e Audituesit	A13-A16
Forma dhe Përmbajtja e Raportit të Audituesit Kur Opinioni është Modifikuar	A17-A26
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	A27
Shtojcë: Ilustrime të Raporteve të Audituesit me Modifikime në Opinion	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit për të lëshuar një raport të duhur, në rrethanat kur gjatë formimit të një opinionit në pajtim me SNA 700¹, audituesi arrin në përfundimin se në opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare duhet të bëhet një modifikim. Ky SNA trajton edhe si ndikohet forma dhe përmbajtja e raportit të audituesit, kur ai shpreh një opinion të modifikuar. Edhe pse nuk janë përsëritur në këtë SNA në të gjitha rastet zbatohen kërkesat e SNA 700 (i rishikuar), përveç rasteve kur ato janë trajtuar në mënyrë eksplicite ose ndryshuar nga kërkesat e këtij SNA-je.

Llojet e Opinioneve të Modifikuara

2. Ky SNA përcakton tre lloje të opinioneve të modifikuara, që janë opinionit me rezervë, opinionit kundër dhe refuzimi për të dhënë opinion. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:
 - (a) Natyra e çështjes që çon në modifikim, d.m.th., nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale, ose në rastin kur nuk mund të sigurohet evidencë e nevojshme e auditimit, mund të jenë të keq paraqitura materialisht, dhe
 - (b) Gjykimi i audituesit në lidhje me shkallën e përhapjes së efekteve ose të ndikimeve të mundshme në pasqyrat financiare (Ref: Para. A1)

Hyrja në fuqi

3. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

Objektivi

4. Objektivi i audituesit është të shprehë qartë një opinion mbi pasqyrat financiare, të modifikuar në mënyrën e duhur, i cili është i nevojshëm kur:
 - (a) Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare të marra në tërësi kanë anomali materiale; ose
 - (b) Audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për të arritur në përfundimin që pasqyrat financiare të marra në tërësi nuk kanë anomali materiale.

Përkufizimet

5. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

¹ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*

MODIFIKIMET E OPINIONIT NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

- (a) I përhapur - Një term, i cili është përdorur në kontekstin e anomalive, për të përshkruar efektet ose efektet e mundshme të anomalive në pasqyrat financiare nëse ka të tilla, të cilat nuk janë zbuluar për shkak të pamundësisë së audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit. Ndikime të përhapura në pasqyrat financiare janë ato ndikime, të cilat sipas gjykimit të audituesit:
 - (i) Nuk janë të kufizuara në elemente, llogari ose zëra të veçanta, të pasqyrave financiare;
 - (ii) Kur janë të kufizuara, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
 - (iii) Në lidhje me informacionet shpjeguese të dhëna, janë themelore për kuptimin e pasqyrave financiare nga përdoruesit e tyre.
- (b) Opinion i modifikuar - Një opinion me rezervë, një opinion kundër ose një refuzim për të dhënë opinion.

Kërkesat

Rrethanat kur Kërkohet një Modifikim në Opinionin e Audituesit

6. Audituesi duhet të modifikojë opinionin në raportin e audituesit kur:

- (a) Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi kanë anomali materiale; ose (Ref: Para. A2-A7)
- (b) Audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit, për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale. (Ref: Para. A8-A12)

Përcaktimi i Llojit të Modifikimit në Opinionin e Audituesit

Opinion me Rezervë

7. Audituesi do të shprehë një opinion me rezervë kur:

- (a) Pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomalitë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, për pasqyrat financiare; ose
- (b) Nuk është në gjendje të marrë evidencën e nevojshme të auditimit mbi të cilën të mbështetet opinionin e tij, por arrin në përfundimin se ndikimet e mundshme në pasqyrat financiare të anomalive të pazbuluara, nëse do të kishte të tilla, mund të jenë materiale por jo të përhapura.

Opinioni Kundër

8. Audituesi do të shprehë një opinion kundër kur ai, pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomali të në pasqyrat financiare, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.

Refuzimi i Opinioni

9. Audituesi do të refuzojë dhënien e një opinioni kur ai nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit mbi të cilën të mbështetë opinionin dhe audituesi arrin në përfundimin se ndikimet e mundshme të anomalive të pazbuluara në pasqyrat financiare, nëse do të kishte të tilla, mund të jenë materiale dhe të përhapura.
10. Audituesi do të refuzojë të japë një opinion kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë paqartësi të shumëfishta, audituesi arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që ai ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me secilën nga pasiguritë individuale, nuk është e mundur që ai të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare për shkak të ndërveprimit të mundshëm të pasigurive dhe efekteve kumulative të mundshme të tyre në pasqyrat financiare.

Pasoja e një Pamundësie për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit për shkak të një Kufizimi të Imponuar nga Drejtimi pasi Audituesi e ka Pranuar Angazhimin

11. Nëse, pas pranimit të angazhimit, audituesi bëhet i vetëdijshëm se drejtimi ka imponuar një kufizim të objektit të auditimit që audituesi e vlerëson të atillë që mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion me rezervë, ose për të refuzuar dhënien e një opinioni mbi pasqyrat financiare, audituesi do t'i kërkojë drejtimit që të heqë kufizimin.
12. Në qoftë se drejtimi refuzon të heqë kufizimin e përmendur në paragrafin 11, audituesi do të komunikojë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç nëse të gjithë ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit² dhe të përcaktojë nëse mund të kryejë procedurat alternative për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit.
13. Nëse audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit, ai duhet të përcaktojë ndikimet si vijon:
- (a) Nëse audituesi arrin në përfundimin që efektet e mundshme të anomalive të pazbuluara në pasqyrat financiare, nëse ka të tilla, mund të jenë materiale por jo të përhapura, ai duhet të japë një rezervë në opinion, ose
- (b) Nëse audituesi arrin në përfundimin që efektet e mundshme të anomalive të pazbuluara në pasqyrat financiare, nëse ka të tilla, mund të jenë aq materiale dhe të përhapura sa që një rezervë në opinion do të jetë e pamjaftueshme për të komunikuar

² SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 13

seriozitetin e situatës, audituesi duhet të:

- (i) Tërhiqet nga auditimi, kur kjo është e mundur sipas ligjit dhe rregullave në fuqi, ose (Ref: Para. A13)
- (ii) Nëse tërheqja nga auditimi përpara se të lëshojë raportin e audituesit nuk është e mundur, ai duhet të refuzojë dhënien e një opinionit mbi pasqyrat financiare (Ref: Para. A14)

14. Nëse audituesi tërhiqet siç tregohet në paragrafin 13 (b)(i), përpara se të tërhiqet, ai do të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen për çështjet që lidhen me anomalitë e identifikuara gjatë auditimit, të cilat do të kishin çuar në një modifikim të opinionit. (Ref: Para. A15)

Konsiderata të Tjera në Lidhje me një Opinion Kundër ose Refuzim të Opinionit

15. Kur audituesi e gjykon të nevojshme të shprehë një opinion kundër ose të refuzojë të japë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, raporti i audituesit nuk duhet të përfshijë në të njëjtën kohë një opinion të pamodifikuar në lidhje me të njëjtin kuadër të raportimit financiar mbi një pasqyrë të vetme financiare ose një apo më shumë elemente të veçanta, llogari ose zëra të një pasqyre financiare. Përfshirja e një opinionit të tillë të pamodifikuar në të njëjtin raport³ në këto rrethana, do të ishte në kundërshtim me opinionin kundër ose me refuzimin e dhënies së opinionit nga audituesi për pasqyrat financiare në tërësi. (Ref: Para. A16)

Forma dhe Përmbajtja e Raportit të Audituesit kur Opinioni është Modifikuar

Opinioni i Audituesit

16. Kur audituesi modifikon opinionin e auditimit, në seksionin opinionit, ai do të përdorë sipas rastit titullin “Opinion me rezervë”, “Opinion kundër”, ose “Refuzim opinionit”, (Ref. Para. A17-A19).

Opinioni me rezervë

17. Kur audituesi shpreh një opinion me rezervë, për shkak të një anomalie materiale në pasqyrat financiare, ai do të deklarojë se, sipas opinionit të audituesit, me përjashtim të efekteve të çështjes (jeve) të përshkruara në seksionin e Bazës për Opininion me Rezervë:

- (a) Kur raportohet sipas një kuadri të paraqitjes së drejtë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë të) [...] në pajtim me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]; ose

³ SNA 805, *Konsiderata të Veçanta - Auditimet e Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare*, merret me rrethanat kur audituesi është angazhuar për të shprehur një opinion të veçantë për një ose më shumë elemente llogari ose zëra specifikë, të pasqyrave financiare.

- (b) Kur raportohet sipas një kuadri të pajtueshmërisë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale në pajtim me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]

Kur modifikimi lind nga një pamundësi për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, audituesi do të përdorë frazën korresponduese “me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes (jeve)...” për opinionin me rezervë (Ref: Para. A20).

Opinionin kundër

- 18. Kur audituesi shpreh një opinion kundër, në paragrafin e opinionit ai do të shprehet se, sipas opinionit të audituesit, për shkak të rëndësisë së çështjes (jeve) të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin Kundër:
 - (a) Kur raportohet sipas një kuadri të paraqitjes së drejtë, pasqyrat financiare bashkëlidhur nuk paraqesin drejt (ose nuk japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të) [...] në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, ose
 - (b) Kur raportohet sipas një kuadri të pajtueshmërisë, pasqyrat financiare bashkëlidhur nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Refuzimi i Opinionit

- 19. Kur audituesi refuzon të japë një opinion për shkak të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, audituesi do të:
 - (a) Shprehet se nuk do të japë një opinion mbi pasqyrat financiare bashkëlidhur;
 - (b) Shprehet se për shkak të rëndësisë së çështjes (jeve) të përshkruara në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinionit, audituesi nuk ka qenë në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion auditimi mbi pasqyrat financiare; dhe
 - (c) Ndryshojë fjalinë që kërkohet nga paragrafi 24(b) i SNA 700 (i rishikuar), që tregon se pasqyrat financiare kane qenë audituar, për të treguar se audituesi ka qenë angazhuar për të audituar pasqyrat financiare.

Baza për opinionin

- 20. Kur audituesi modifikon opinionin mbi pasqyrat financiare, përveç elementeve specifike të kërkuara nga SNA 700 (i rishikuar) ai do të: (Ref. Para. A.21)
 - (a) Ndryshojë titullin “Baza për Opinionin” që kërkohet nga paragrafi 28 i SNA 700 (i rishikuar) duke e zëvendësuar sipas rastit me titullin “Baza për Opinionin me Rezervë”, “Baza për Opinionin Kundër”, ose “Baza për Refuzimin e Opinionit”.

- (b) Përfshijë brenda këtij seksioni një përshkrim të çështjeve që çojnë në modifikim.
21. Nëse ka një anomali materiale në pasqyrat financiare që lidhet me shumata e veçanta në pasqyrat financiare (përfshirë shumata sasiore të shpjguara në shënimet e pasqyrave), audituesi do të përfshijë në seksionin e Bazës për Opinionin një përshkrim dhe një vlerësim sasior të efekteve financiare të anomalisë, përveç nëse kjo nuk është e mundur. Nëse nuk është e mundur të përcaktojë nga pikëpamja sasiore efektet financiare, audituesi do ta shprehë këtë gjë në këtë seksion. (Ref: Para. A22)
22. Nëse ka një anomali materiale në pasqyrat financiare që lidhet me informacionet shpjguese narrative, audituesi do të përfshijë në seksionin e Bazës për Opinionin një shpjgim që tregon se si informacioni është keq paraqitur.
23. Nëse ka një anomali materiale në pasqyrat financiare që lidhet me mos dhënien e informacionit që kërkohet të jepet në shpjgime, audituesi do të:
- (a) Diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen, për informacionin që nuk është paraqitur në shënimet shpjguese;
 - (b) Përshkruajë në Bazën për Opinionin, natyrën e informacionit që mungon dhe përveç nëse ndalohet nga ligji ose rregullat, do të përfshijë informacionin që mungon në shënimet shpjguese, në qoftë se kjo është e mundur të bëhet dhe audituesi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me informacionin që mungon. (Ref: Para. A23)
24. Nëse modifikimi rrjedh nga një pamundësi për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, në seksionin e Bazës për Opinionin, audituesi do të japë edhe arsyet e kësaj pamundësie.
25. Kur audituesi shpreh një opinion me rezervë ose një opinion kundër, ai duhet të ndryshojë fjalinë për faktin nëse evidenca e auditimit e siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin e audituesit, të kërkuar nga paragrafi 28 (d) i SNA 700 (i rishikuar) për të përfshirë sipas rastit fjalët “me rezervë” ose “kundër”.
26. Kur audituesi refuzon të japë një opinion për pasqyrat financiare, raporti i audituesit nuk do të përfshijë elementet e kërkuar nga paragrafët 28 (b) dhe 28 (d) të SNA 700 (i rishikuar). Këto elemente janë:
- (a) Një referencë tek seksioni i raportit të audituesit ku janë përshkruar përgjegjësitë e audituesit; dhe
 - (b) Një deklaratë/fjali që tregon nëse evidenca e auditimit e siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin e audituesit.
27. Madje edhe nëse audituesi ka shprehur një opinion kundër ose ka refuzuar të japë një opinion mbi pasqyrat financiare, në seksionin e Bazës për Opinionin ai do të përshkruajë

arsyet për çdo çështje tjetër, për të cilën audituesi është i vetëdijshëm se do të kishte kërkuar një modifikim në opinion dhe efektet e tyre. (Ref: Para. A24)

Përshkrimi i Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, kur Audituesi Refuzon të japë Opinion mbi Pasqyrat Financiare

28. Kur audituesi refuzon të japë një opinion për shkak të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, ai duhet të ndryshojë përshkrimin e përgjegjësive të kërkuara nga paragrafët 38-40 të SNA 700 (i rishikuar) për të përfshirë vetëm sa vijon: (Ref: Para. A25)
- (a) Një deklaratë që tregon se përgjegjësia e audituesit është të kryejë auditimin e pasqyrave financiare të entitetit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojë një raport auditimi;
 - (b) Një deklaratë që tregon se megjithatë, për shkak të çështjes (jeve) të përshkruara në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinionit , audituesi nuk ka qenë në gjendje të marrë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit mbi pasqyrat financiare; dhe
 - (c) Një deklaratë në lidhje me pavarësinë e audituesit dhe për përgjegjësitë e tjera etike të kërkuara nga paragrafi 28 (c) i SNA 700 (i rishikuar).

Konsiderata kur Audituesi Refuzon të japë një Opinion mbi Pasqyrat Financiare

29. Përveç nëse kur kërkohet nga ligji ose rregullat, kur audituesi refuzon të japë një opinion mbi pasqyrat financiare, raporti i audituesit nuk do të përfshijë një seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit në pajtim me SNA 701^{4,5}. (Ref: Para. A.26)

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

30. Kur audituesi parashikon të modifikojë opinionin në raportin e audituesit, ai duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me rrethanat që çojnë në modifikimin që parashikohet dhe për formulimin e propozuar të modifikimit. (Ref: Para. A27)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Llojet e Opinioneve të Modifikuara (Ref: Para. 2)

- A1. Tabela e mëposhtme ilustron mënyrën se si ndikon në llojin e opinionit që duhet të shprehet, gjykimi i audituesit për natyrën e çështjes që çon në modifikim, dhe për shkallën e përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme të saj në pasqyrat financiare.

⁴ SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafët 11–13

⁵ SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera*, paragrafi A54

Natyra e çështjes që çon në modifikim	Gjykimi i audituesit në lidhje me përhapjen e Efekteve ose Efekteve të mundshme në Pasqyrat Financiare	
	Material, por jo i përhapur	Material dhe i përhapur
Pasqyrat financiare janë keq paraqitur materialisht	Opinion me rezervë	Opinion Kundër
Pamundësia për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit	Opinion me rezervë	Refuzim Opinioni

Rrethanat kur kërkohet një Modifikim për Raportin e Audituesit

Natyra e anomalive materiale (Ref: Para. 6(a))

A2. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që, për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare audituesi të arrijë në përfundimin nëse është arritur siguria e arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale⁶. Ky përfundim merr në konsideratë vlerësimin e audituesit për anomalitë e pakorrigjuara në pasqyrat financiare, nëse ka të tilla, në pajtueshmëri me SNA 450⁷.

A3. SNA 450 e përcakton një anomali si një diferencë midis shumës, klasifikimit, paraqitjes, ose informacionit shpjgues të dhënë për një element ose një shumë të pasqyrës financiare të raportuar dhe shumës, klasifikimit, paraqitjes apo informacionit shpjgues të dhënë që kërkohet të jetë për elementin për të qënë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. Për rrjedhojë, një anomali materiale në pasqyrat financiare mund të lindë në lidhje me:

- (a) Përshtatshmërinë e politikave kontabël të zgjedhura;
- (b) Zbatimin e politikave kontabël të zgjedhura; ose
- (c) Përshtatshmërinë ose mjaftueshmërinë e informacioneve shpjguese të dhëna në pasqyrat financiare.

Përshtatshmëria e Politikave Kontabël të Zgjedhura

A4. Anomali të materiale në pasqyrat financiare në lidhje me përshtatshmërinë e politikave kontabël të zgjedhura nga drejtimi, mund të lindin kur:

- (a) Politikat kontabël të zgjedhura nuk janë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; ose
- (b) Pasqyrat financiare, përfshirë edhe shënimet shpjguese të tyre, nuk paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në një mënyrë tillë që të arrihet paraqitja e drejtë.

⁶ SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 11

⁷ SNA 450, *Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara Gjatë Auditimit*, paragrafi 11

A5. Kuadrot e raportimit financiar shpesh përmbajnë kërkesa për kontabilizimin dhe për dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me ndryshimet në politikat kontabël. Kur entiteti ka ndryshuar zgjedhjen e tij për politikat e rëndësishme kontabël, një anomali materiale e pasqyrave financiare mund të lindë kur entiteti nuk ka vepruar në pajtim me këto kërkesa.

Zbatimi i Politikave Kontabël të Zgjedhura

A6. Në lidhje me zbatimin e politikave kontabël të zgjedhura, anomalitë materiale në pasqyrat financiare mund të lindin:

- (a) Kur politikat kontabël të zgjedhura drejtimi nuk i ka zbatuar në koherencë me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, përfshirë rastin, kur drejtimi nuk i ka zbatuar politikat kontabël të zgjedhura me koherencë për periudha të ndryshme ose për transaksione dhe ngjarje të ngjashme (qëndrueshmëri në aplikim), ose
- (b) Për shkak të metodës së zbatimit të politikave kontabël të zgjedhura (siç është një gabim i paqëllimshëm në zbatim).

Përshtatshmëria ose Mjaftueshmëria e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare

A7. Në lidhje me përshtatshmërinë, ose mjaftueshmërinë e dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare, anomalitë materiale në pasqyrat financiare mund të lindin kur:

- (a) Pasqyrat financiare nuk përfshijnë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar;
- (b) Informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare nuk janë paraqitur në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; ose
- (c) Pasqyrat financiare nuk japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Natyrë e një Pamundësie për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit (Ref: Para. 6 (b))

A8. Pamundësia e audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit (referuar gjithashtu si një kufizim i objektit të auditimit) mund të lindë nga:

- (a) Rrethanat që nuk janë nën kontrollin e entitetit;
- (b) Rrethanat në lidhje me natyrën apo afatet e punës së audituesit; ose
- (c) Kufizimet e imponuara nga drejtimi.

A9. Një pamundësi për të kryer një procedurë të veçantë nuk përbën një kufizim të objektit të auditimit nëse audituesi është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit përmes kryerjes së procedurave alternative. Nëse kjo nuk është e mundur, zbatohen sipas rastit, kërkesat e paragrafëve 7(b) dhe 9-10. Kufizimet e imponuara nga drejtimi mund të

kenë ndikime të tjera për auditimin, siç janë ndikimet në vlerësimin që audituesi ju bën rreziqeve të mashtrimit dhe në vlerësimin që ai bën për vazhdimin e angazhimit.

A10. Shembuj të rrethanave që janë jashtë kontrollit të entitetit përfshijnë rastet kur:

- Regjistrat kontabël të entitetit janë shkatërruar.
- Regjistrat kontabël të një komponenti të rëndësishëm të entitetit janë konfiskuar nga autoritetet qeveritare për një kohë të pacaktuar.

A11. Shembuj të rrethanave që lidhen me natyrën apo afatet e punës së audituesit përfshijnë rastet kur:

- Entiteti kërkohet të përdorë metodën e kapitalit neto për trajtimin kontabël të një entiteti të lidhur (pjesëmarrje) dhe audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar më të fundit për të vlerësuar nëse metoda e kapitalit neto është zbatuar siç duhet.
- Koha kur emërohet audituesi është e tillë që ai nuk është në gjendje të vëzhgojë numërimin fizik të inventarëve.
- Audituesi vlerëson se nuk është e mjaftueshme kryerja vetëm e procedurave thelbësore, pasi kontrollet e entitetit nuk janë efektive.

A12. Shembuj të një pamundësie për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit që rrjedhin nga një kufizim i objektit të auditimit të imponuar nga drejtimi, përfshijnë rastet kur:

- Drejtimi nuk e lejon audituesin të vëzhgojë numërimin fizik të inventarëve.
- Drejtimi e pengon audituesin të kërkojë konfirmime nga të tretët për teprica të llogarive të veçanta.

Përcaktimi i Llojit të Modifikimit në Opinionin e Audituesit

Pasoja e një Pamundësie për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit për shkak të një Kufizimi të Imponuar nga Drejtimi, pasi Audituesi e ka pranuar Angazhimin (Ref: Para. 13 (b)(i) - 14)

A13. Mundësia e tërheqjes nga auditimi mund të varet nga faza në të cilën ndodhet kryerja e angazhimit në momentin kur drejtimi imponon kufizim në objekt. Nëse audituesi ka kryer një punë të konsiderueshme të auditimit, ai përpara se të tërhiqet mund të vendosë të përfundojë auditimin deri në masën e mundshme, të refuzojë të japë një opinion dhe të shpjegojë kufizimin e objektit në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinionit.

A14. Në disa rrethana, tërheqja nga auditimi nuk mund të jetë e mundur në qoftë se audituesi kërkohet nga ligji ose rregullat që të vazhdojë angazhimin e auditimit. Këtu mund të jetë rasti i një audituesi që është emëruar për auditimin e pasqyrave financiare të entiteteve të sektorit publik. Gjithashtu, këtu mund të jetë rasti në ato juridiksione ku audituesi caktohet për të audituar pasqyrat financiare që mbulojnë një periudhë të caktuar, ose kur audituesi emërohet për një periudhë të caktuar dhe është e ndaluar që ai të tërhiqet respektivisht para kryerjes së auditimit të këtyre pasqyrave financiare ose para fundit të

kësaj periudhe. Gjithashtu, audituesi mund të konsiderojë të nevojshme që në raportin e audituesit të përfshijë një paragraf për çështje të tjera.⁸

A15.Kur audituesi arrin në përfundimin se për shkak të një kufizimi të objektit, duhet të tërhiqet nga auditimi, ai duhet të mbajë parasysh kërkesat profesionale, ligjore ose rregullatore për të komunikuar çështjet që lidhen me tërheqjen nga angazhimi me rregullatorët apo pronarët e entitetit.

Konsiderata të Tjera në Lidhje me një Opinion Kundër ose me Refuzim Opinioni (Ref: Para. 15)

A16.Më poshtë jepen shembuj të rrethanave të raportimit që nuk do të ishin në kundërshtim me opinionin kundër ose me refuzimin e opinionit nga audituesi:

- Shprehja e një opinionit të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të përgatitura sipas një kuadri të dhënë të raportimit financiar dhe shprehja, brenda të njëjtit raport, e një opinionit kundër për të njëjtën pasqyrë financiare të përgatitur sipas një kuadri të ndryshëm të raportimit financiar⁹.
- Shprehja e një refuzimi opinionit në lidhje me rezultatet e operacioneve, dhe flukset e parave, kur është e përshtatshme, dhe e një opinionit të pamodifikuar në lidhje me pozicionin financiar (shiko SNA 510¹⁰). Në këtë rast, audituesi nuk ka shprehur një refuzim opinionit mbi pasqyrat financiare në tërësi.

Forma dhe përmbajtja e Raportit të Audituesit Kur Opinioni është Modifikuar

Raporte Audituesi Ilustruese (Ref: Para.16)

A17.Ilustrimet 1 dhe 2 në Shtojcë përmbajnë respektivisht raporte të audituesit me opinion me rezervë dhe opinion kundër, për shkak se pasqyrat financiare kanë anomali materiale.

A18.Ilustrimi 3 në Shtojcë përmban një raport të audituesit me një opinion me rezervë, për shkak se audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit. Ilustrimi 4 përmban një refuzim për dhënie opinionit për shkak të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit për një element të veçantë të pasqyrave financiare. Ilustrimi 5 përmban një refuzim opinionit për shkak të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit rreth disa elementeve të pasqyrave financiare. Në secilin nga dy rastet e fundit, efektet e mundshme në pasqyrat financiare të pamundësisë janë si materiale ashtu edhe të përhapura. Shtojcat në SNA-të e tjera që përfshijnë kërkesa raportimi, përfshirë SNA 570¹¹ (i rishikuar), përmbajnë gjithashtu ilustrime të raporteve të audituesit me opinione

⁸ SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi A10

⁹ Për një përshkrim të kësaj rrethane shiko paragrafin A31 të SNA 700 (i rishikuar)

¹⁰ SNA 510, *Angazhimet fillestare të Auditimit – Tepricat e Çeljes*, paragrafi 10

¹¹ SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*

të modifikuara.

Opinionit i Audituesit (Ref: Para.16)

A19. Amendimi i këtij titulli e bën më të qartë për përdoruesit faktin që raporti i audituesit është i modifikuar dhe tregon për llojin e modifikimit.

Opinionit me rezerve (Ref. Para.17)

A20. Kur audituesi shpreh një opinion me rezervë, nuk do të ishte e përshtatshme që në seksionin e opinionit të përdoren fraza të tilla si: “me shpjegimin e dhënë më lart” ose “kushtëzuar nga”, pasi ato nuk janë të qarta dhe detyruese.

Baza për Opinionin (Ref: Para. 20, 21, 23, 27)

A21. Qëndrueshmëria në raportin e audituesit ndihmon përdoruesit të kuptojnë dhe të identifikojnë rrethanat e pazakonta kur ato ndodhin. Prandaj, ndonëse mund të mos ketë uniformitet në formulimin e një opinionit të modifikuar dhe në përshkrimin e bazës për modifikim, është e dëshirueshme të ketë koherencë (qëndrueshmëri) si në formë ashtu edhe në përmbajtjen e raportit të audituesit.

A22. Një shembull i efekteve financiare të anomalive materiale që audituesi mund të përshkruajë brenda seksionit të Bazës për Opinionin në raportin e audituesit është dhënia e efekteve sasiore për tatimin mbi të ardhurat, të ardhurat para tatimeve, të ardhurat neto dhe të kapitalit në qoftë se është mbivlerësuar inventari.

A23. Dhënia e informacioneve që mungojnë në seksionin e Bazës për Opinionin, nuk do të jetë e mundur në qoftë se:

- (a) Informacionet që shpjegohen nuk janë përgatitur nga drejtimi ose nëse këto informacione nuk janë të disponueshme për audituesin; ose
- (b) Sipas gjykimit të audituesit, dhënia e informacioneve shpjeguese do të ishte mjaft voluminoze për raportin e audituesit.

A24. Një opinion kundër ose një refuzim për dhënie opinionit në lidhje me një çështje të caktuar të përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin, nuk e justifikon mungesën e një përshkrimi të çështjeve të tjera të identifikuar, që përndryshe do të kishin qënë kërkuar për një opinion të audituesit të modifikuar. Në këto raste, dhënia e informacioneve për këto çështje të tjera, për të cilat audituesi ka dijeni, mund të jetë e rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare.

Përshkrimi i Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, kur Audituesi Refuzon një Opinion mbi Pasqyrat Financiare (Ref: Para. 28)

A25. Kur audituesi refuzon të japë një opinion mbi pasqyrat financiare, është mirë që brenda seksionit të Përgjegjësive të Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare në raportin e

audituesit të vendosen fjalitë e mëposhtme, sikurse ato janë dhënë në ilustrimet 4-5 të Shtojcës së këtij SNA-je:

- Fjalja që kërkohet nga paragrafi 28(a) i SNA 700 (i rishikuar), i amenduar për të treguar se përgjegjësia e audituesit është të kryejë një auditim të pasqyrave financiare të entitetit në pajtim me SNA-të ; dhe
- Fjalja që kërkohet nga paragrafi 28(c) i SNA 700 (i rishikuar) rreth pavarësisë dhe përgjegjësive të tjera etike.

Konsiderata kur Audituesi Refuzon Opinionin mbi Pasqyrat Financiare (Ref: Para.29)

A26. Shpjegimi i arsyeve lidhur me pamundësinë e audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit brenda seksionit të Bazës për Refuzimin e Opinionit në raportin e audituesit, ju jep përdoruesve informacione të dobishëm për të kuptuar pse audituesi e ka refuzuar opinionin mbi pasqyrat financiare dhe mund të shërbejë edhe për të shmangur një mbështetje të papërshtatshme tek këto pasqyra. Megjithatë, komunikimi i ndonjë çështje kryesore të auditimit që ndryshon nga ato që çojnë në refuzimin e opinionit mund të tregojë që pasqyrat financiare në tërësi janë më të besueshme në lidhje me këto çështje se sa ato do të ishin në të vërtetë të përshtatshme për rrethanat, dhe kjo nuk do të ishte në koherencë me refuzimin e opinionit për pasqyrat financiare në tërësi. Prandaj, paragrafi 29 i këtij SNA-je nuk lejon që në raportin e audituesit të përfshihet seksioni i Çështjeve Kryesore të Auditimit kur audituesi refuzon të japë opinion mbi pasqyrat financiare, përveç nëse nga ligji ose nga rregullat kërkohet që audituesi të komunikojë çështjet kryesore të auditimit.

Komunikimi me personat e ngarkuar me Qeverisjen (Ref: Para. 30)

A27. Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen, i rrethanave që çojnë në një modifikim të pritshëm të opinionit të audituesit dhe në formulimin e propozuar të modifikimit, bën të mundur që:

- (a) Audituesi të njoftojë personat e ngarkuar me qeverisjen për modifikimet e parashikuara dhe për arsyet (apo rrethanat) për modifikimin (et);
- (b) Audituesi të kërkojë pëlqimin e personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me faktet e çështjes (jeve) që çojnë në modifikimet e pritshme, ose për të konfirmuar çështjet e mospajtitimit me drejtimin, si të tilla, dhe
- (c) Personat e ngarkuar me qeverisjen, kur është e mundur, të kenë një mundësi, për t'i siguruar audituesit informacion të mëtejshëm dhe shpjegime në lidhje me çështjen (jet) që çojnë në modifikimet e pritshme.

Ilustrimet e Raporteve të Audituesit me Modifikime në Opinion

- Ilustrimi 1: Raporti i audituesit përmban një opinion me rezervë për shkak të një anomalie materiale të pasqyrave financiare.
- Ilustrimi 2: Raporti i audituesit përmban një opinion kundër për shkak të një anomalie materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara.
- Ilustrimi 3: Raporti i audituesit përmban një opinion me rezervë për shkak të pamundësisë së audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me një entitet të lidhur (pjesëmarrje) të huaj.
- Ilustrimi 4: Raporti i audituesit përmban një refuzim të opinionit për shkak të pamundësisë së audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me një element të vetëm të pasqyrave financiare të konsoliduara.
- Ilustrimi 5: Raporti i audituesit përmban një refuzim të opinionit për shkak të pamundësisë së audituesit për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit për disa elementë të pasqyrave financiare.

Ilustrimi 1: - Opinion me Rezervë për shkak të një Anomalie Materiale të Pasqyrave Financiare

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një Grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600¹²).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjesisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210¹³.
- Inventarët janë keq paraqitur. Anomalia duket se është materiale por jo e përhapur në pasqyrat financiare (d.m.th. duhet të jepet një opinion me rezervë)
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, në pajtim me SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe çështja që ka çuar në opinionin me rezervë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara ka ndikim edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁴**Opinionin me rezervë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave

¹² SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e audituesit të entitetit të kontrolluar)*

¹³ SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit*

¹⁴ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është nevoja të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Inventarët e shoqërisë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën xxx. Drejtimi nuk i ka paraqitur inventarët me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, por vetëm me kosto, çka përbën një devijim nga kërkesat e SNRF-ve. Regjistrat e shoqërisë tregojnë se nëse drejtimi do t'i kishte paraqitur inventarët me më të ultën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, një shumë prej xxx do të paraqitej si pakësim/rënie e vlerës së inventarëve për t'i çuar ato deri në vlerën e tyre neto të realizueshme. Për rrjedhojë, kostot e shitjes do të ishin rritur me xxx dhe tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat neto dhe kapitali i aksionarëve do të ishin reduktuar respektivisht me xxx, xxx dhe xxx.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko ilustrimin 6 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar). Paragrafi i fundit i seksionit të informacioneve të tjera në ilustrimin 6 duhet të modifikohet për të përshkruar çështjet specifike që kanë çuar në opinionin me rezervë, të cilat kanë ndikim edhe në informacionet e tjera.]

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë, ne kemi përcaktuar çështjet më poshtë si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare¹⁵

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar)]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹⁵ Në të gjitha këto raporte audituesi ilustruese, termat drejtimi dhe presonat e ngarkuar me qeverisjen mund të zëvendësohen me një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

Ilustrimi 2: - Opinion Kundër për shkak të një Anomalie Materiale në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një Grupi të një entiteti me filiale (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë keq paraqitur materialisht për shkak të mos konsolidimit të një filiali. Anomalia materiale duket se është e përhapur në pasqyrat financiare të konsoliduara. Efektet e anomalisë në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk janë përcaktuar për shkak se nuk ka qenë e mundur (d.m.th. duhet të jepet një opinion kundër)
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, në pajtim me SNA 570 (i rishikuar)
- Zbatohet SNA 701, megjithatë audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka çështje kryesore të auditimit përveç atyre të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin Kundër.
- Audituesi i ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe çështja që ka çuar në opinionin me rezervë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara ka ndikim edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara¹⁶

Opinionin kundër

¹⁶ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare ABC dhe filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes të trajtuar në seksionin e Bazës për Opinionin Kundër të raportit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur nuk paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose nuk japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin kundër

Sikurse shpjegohet në shënimin X, Grupi nuk ka konsoliduar filialin XYZ, të cilën Grupi e ka blerë gjatë 20X1, për shkak se nuk ka qenë në gjendje të përcaktonte vlerat e drejta të disa prej aktiveve dhe detyrimeve materiale të filialit në datën e blerjes. Për këtë arsye, investimi është njohur me kosto. Sipas SNRF-ve shoqëria duhet të kishte konsoliduar filialin e saj për blerjen, bazuar në shumat provizore. Nëse filiali XYZ do të kishte qenë konsoliduar, shumë elemente në pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur do të ndikoheshin materialisht. Efektet në pasqyrat financiare të konsoliduara që lidhen me mos konsolidimin nuk janë përcaktuar.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë kundër.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko ilustrimin 7 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar). Paragrafi i fundit i seksionit të informacioneve të tjera në ilustrimin 7 duhet të modifikohet për të përshkruar çështjet specifike që kanë çuar në opinionin me rezervë, të cilat kanë ndikim edhe në informacionet e tjera.]

Çështjet Kryesore të Auditimit

Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin Kundër, ne nuk kemi përcaktuar çështje tjetër, të cilën duhet ta komunikojmë në raportin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara¹⁷

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar)]

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (të rishikuar)– shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹⁷ Ose terma të tjera që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

Ilustrimi 3: - Opinion me Rezervë për shkak të Pamundësisë së Audituesit për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit në lidhje me një Entitet të lidhur (pjesëmarrje) të huaj

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një Grupi të një entiteti me filiale (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi nuk ishte në gjendje të siguronte evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me investimin në një pjesëmarrje të huaj. Efektet e mundshme të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit duket se janë materiale por jo të përhapura në pasqyrat financiare të konsoliduara (d.m.th. duhet të jepet një opinion me rezervë)
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet e cila mund të hedhë dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar)
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkojnë sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara¹⁸

Opinion i me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare ABC dhe të filialeve të saj (Grupit), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për

¹⁸ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin me Rezervë

Investimi i grupit në shoqërinë XYZ, një pjesëmarrje e huaj e blerë gjatë vitit dhe e njohur me metodën e kapitalit, është paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në shumën xxx me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe pjesa e të ardhurave neto të shoqërisë ABC tek pjesëmarrja XYZ në shumën xxx është përfshirë në të ardhurat e shoqërisë ABC për vitin që mbyllet me këtë datë. Ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me vlerën kontabël të investimit të shoqërisë ABC tek pjesëmarrja XYZ me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe pjesën e ABC në të ardhurat neto të XYZ për këtë vit, për shkak se nuk na u lejua akses në informacionet financiare, tek drejtimi dhe tek audituesit e XYZ. Për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të ishte nevoja të bëhej ndonjë rregullim i këtyre shumave.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko ilustrimin 6 në Shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar). Paragrafi i fundit i seksionit të informacioneve të tjera në ilustrimin 6 duhet të modifikohet për të përshkruar çështjet specifike që kanë çuar në opinionin me rezervë, të cilat kanë ndikim edhe në informacionet e tjera.]

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim opinion të veçantë.

Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë, ne kemi përcaktuar çështjet më poshtë si çështje kryesore të auditimit që komunikohen në raportin tonë të auditimit.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara¹⁹

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e auditimit është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹⁹ Ose terma të tjera që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

Ilustrimi 4: - Refuzim i Opinionit për shkak të Pamundësisë për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit për një Element të vetëm të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një grupi të një entiteti me filiale (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi nuk ishte në gjendje të siguronte evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me një element të vetëm të pasqyrave financiare të konsoliduara. Kjo do të thotë që audituesi nuk ishte në gjendje të siguronte evidencën e nevojshme të auditimit për një investim në një sipërmarrje të përbashkët që përfaqëson 90 për qind të aktiveve neto të entitetit. Efektet e mundshme të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit duket se janë materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare të konsoliduara (d.m.th. duhet të refuzohet opinionin).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Kërkohet të vendoset një seksion më i kufizuar i përshkrimit të përgjegjësive të audituesit.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara²⁰

Refuzimi i Opinionit

Ne u angazhuam për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare ABC dhe të filialeve të saj (Grupit), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të

²⁰ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit bashkëlidhur. Për shkak të rëndësisë së çështjes të trajtuar në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinionit të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që do të na jepte një bazë për një opinion auditimi mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Baza për Refuzimin e Opinionit

Investimi i grupit në shoqërinë e përbashkët XYZ, është paraqitur në shumën xxx në pasqyrën e pozicionit financiar të Grupit. Kjo shumë përfaqëson mbi 90 % të aktiveve neto të Grupit me datën 31 Dhjetor 20X1. Ne nuk na u lejua akses tek drejtimi dhe tek audituesit e XYZ, si edhe tek dokumentacioni i audituesve të XYZ. Për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të ishte nevoja të bëhej ndonjë rregullim në lidhje me pjesën proporcionale të aktiveve të Grupit tek shoqëria XYZ që kontrollohet bashkërisht, të pjesën proporcionale të detyrimeve të XYZ për të cilat është bashkërisht përgjegjëse, pjesën proporcionale të të ardhurave dhe shpenzimeve të XYZ për vitin dhe të elementeve që formojnë pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital; dhe në pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare²¹

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia jone është të kryejmë një auditim të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojmë një raport audituesi. Megjithatë, për shkak të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinionit të raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit që do të na jepte një bazë për opinionin tonë mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Ne jemi të pavarur nga grupi në pajtim me kërkesat etike që zbatohen për auditimin e pasqyrave financiare në (juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur të gjitha përgjegjësitë e tjera etike në pajtim me këto kërkesa.

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (të rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i Rishikuar).]

²¹ Ose terma të tjera që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

MODIFIKIMET E OPINIONIT NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e auditimit është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

Ilustrimi 5: - Refuzim opinionit për shkak të Pamundësisë së audituesit për të Siguruar Evidencën e Nevojshme të Auditimit rreth disa Elementeve të Pasqyrave Financiare

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një Grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi nuk ishte në gjendje të siguronte evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me disa elemente të pasqyrave financiare, që do të thotë se audituesi nuk ishte në gjendje të siguronte evidencën e nevojshme të auditimit për inventarët dhe llogaritë e arkëtueshme. Efektet e mundshme të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit duket se janë materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Kërkohet të vendoset një seksion më i kufizuar i përshkrimit të përgjegjësive të audituesit.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare²²**Refuzim i opinionit**

Ne u angazhuam për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare bashkëlidhur të shoqërisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në seksionin e Bazës për Refuzimin e Opinioneve të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që do të na jepte një bazë për një opinion auditimi mbi këto pasqyra financiare.

²² Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Baza për Refuzimin e Opinionit

Ne nuk kemi qene emëruar auditues të shoqërisë deri me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe nuk mundëm të ishim të pranishëm në procesin e inventarizimit fizik në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk mund të krijojmë bindjen me mjete të tjera alternative në lidhje me sasinë e inventarit me datën 31 Dhjetor 20X0 dhe 20X1, të cilat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar respektivisht në shumat xxx dhe xxx. Veç kësaj, vënia në zbatim e një sistemi të kompjuterizuar për trajtimin e llogarive të arkëtueshme në shtator 20X1, ka çuar në një numër gabimesh në llogaritë e arkëtueshme. Deri në datën e raportit tonë drejtimi po punonte për të rregulluar gabimet dhe për të korrigjuar sistemin kompjuterik. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmim ose verifikim me mjete alternative llogaritë e arkëtueshme të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar për totalin xxx me datën 31 Dhjetor 20X1. Si rrjedhojë e këtyre çështjeve, ne nuk kemi qenë në gjendje të përcaktonim nëse duhet të bëhet ndonjë rregullim në lidhje me inventarët dhe llogaritë e arkëtueshme të regjistruara apo të paregjistruara, si edhe për elementet përbërës të të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrës së ndryshimeve në kapital dhe pasqyrës së flukseve të parasë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare²³

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia jonë është të kryejmë një auditim të pasqyrave financiare shoqërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojmë një raport audituesi. Megjithatë, për shkak të çështjeve të përshkruara në seksion e Bazës për Refuzimin e Opinionit të raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit që do të na jepte një bazë për opinionin tonë mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në pajtim me kërkesat etike që zbatohen për auditimin e pasqyrave financiare në (juridiksionin përkatës) dhe ne kemi përmbushur të gjitha përgjegjësitë e tjera etike në pajtim me këto kërkesa.

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

²³ Ose terma të tjera që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.